REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (d), nenit 14, 17 pika (n) dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26 shtator 2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29.03.2018 miratojë këtë:

# VENDIM
## PËR NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMËRISË P-71409044-00846-10 NGA P.SH SHKOLLA BUJQËSORE LIPJAN NË P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN PËR NDËRTIMIN E TREGUT TË GJELBËR

### Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet emërtimi i titullarit të paluajtshmërisë-parcelës kadastrale P-71409044-00846-10 në vendin e quajtur "Bezimeni" me sipërfaqe prej 15926 $m^2$ Zona kadastrale Lipjan, nga P.SH Shkolla Bujqësore Lipjan në P.SH Kuvendi Komunal Lipjan.

### Neni 2

Paluajtshmëria-parcela kadastrale nga nenin 1 e këtij Vendimi destinohet për ndërtimin e tregut të gjelbër në kuadër të Zonës Urbane Lindore "ZUL-8"

### Neni 3

Destinimi i paluajtshmërisë-parcelës kadastrale për ndërtimin e tregut të gjelbër duhet të inkorporohet në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale si dokumente të planifikimit të cilat janë në proces të hartimit sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.011-41550 të datës 01.0

### Neni 4

Bazuar në këtë Vendim mund të zhvillohen procedurat për leje ndërtimi.

### Neni 5

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e ndyshimit-regjistrimit të titullarit nga P.Sh Shkolla Bujqësore Lipjan në P.SH Kuvendin Komunal Lipjan siq përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Inspekcion dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

**15Nr.** 463 – 20225

**Lipjan, më 30.03. 2018**

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Daut Azemi**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
LIPJAN